



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __/__/2019

Lënda: Depozitimi i një projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.7651. datë 21.12.1992, "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar”.

Drejtuar: Z. GRAMAZ RUÇI

KRYETARI KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Bazuar në nenin 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e subjektit kushtetues, për të ndërmarrë nismë, propozoj projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.7651. datë 21.12.1992. "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar”.

Përmes këtij amendamenti, propozohet shpallja si festë zyrtare në Republikën e Shqipërisë së:

- Datës 7 janar si dita e Krishtlindjeve sipas kalendarit Julian për pakicat kombëtare maqedonase, sërbe dhe malazeze të besimit ortodoks.

Të krishterët ortodoks në Evropën lindore por edhe pjesë të tjera të botës e festojnë Krishtlindjen më 7 janar, bazuar në kalendarin Julian.

Festa e Krishtlindjes është një ndër festat më të rëndësishme për të krishterët ortodoks dhe për këtë qëllim, festimi i tyre në mënyrë dinjitoze është një domosdoshmëri për të gjitha pakicat kombëtare maqedonase, sërbe dhe malazeze.

Aktualisht ligji nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 12, pika 2, ka përcaktuar: “Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, gëzojnë, në përputhje me përcaktimet e nenit 2, të këtij ligji, të drejtën e krenimit të ngjarjeve që lidhen me promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor.”

Nga analizimi i dispozitave të ligjit nr.7651. datë 21.12.1992. "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar", konstatohet se kjo e drejtë e këtyre pakicave nuk gjen dot zbatim dhe nuk është reflektuar.

Vlerësoj se ky propozim do të mundësojë adresim dhe garantimin e të këtyre të drejtave për pakicat kombëtare maqedonase, serbe dhe malazeze të besimit ortodoks. Në mbështetje të kësaj nisme janë shprehur edhe Këshilli Bashkiak i Bashkisë Pustec, i cili e sheh si shumë të nevojshme, duke u nisur nga fakti se Bashkia e Pustecit banohet me popullsi 100% maqedonase të besimit ortodoks dhe festat ortodokse banorët e kësaj bashkie i festojnë me kalendarin Julian. Gjithashtu në mbështetje të kësaj nisme janë shprehur dhe shoqatat, të cilat mborjnë interesat e pakicave kombëtare maqedonase, serbe dhe malazeze të besimit ortodoks, si dhe Komiteti Shtetëror i Minoriteteve.

Për gjithë sa më sipër, bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës për të plotësuar mangësitë e sipërcituara, propozoj projektligjin , "Për një ndryshim në ligjin nr.7651. datë 21.12.1992. "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar", përmes të cilit shtohet si ditë pushimi/feste zyrtare data 7 janar si dita e Krishtlindjeve sipas kalendarit Julian për pakicat kombëtare maqedonase, serbe dhe malazeze të besimit ortodoks.

Bashkëngjitur me këtë kërkesë, do të gjeni projektligjin "Për një ndryshim në ligjin nr.7651. datë 21.12.1992. "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar".

DEPUTETI PROPOZUES

Vasil Sterjovski





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

NR ____/

**“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7651. DATË 21.12.1992, "PËR FESTAT
ZYRTARE E DITËT PËRKUJTIMORE", TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me
propozim të një deputeti,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 1 të ligjit nr. 7651, date 21.12.1992, "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të
ndryshuar, pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“ f. 7 janari, Krishtlindjes Ortodokse dita e parë dhe Pashkët ortodokse dita e parë, sipas
Kalendarit Julian, për pakicat kombëtare, maqedonase, serbe dhe malazeze të besimit
ortodoks”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I KUVENDIT

GRAMOZ RUÇI